



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Raport përmbledhës: Statistikat e Energjisë

Prishtinë, Prill 2024

PËRMBLEDHJE E STATISTIKAVE TË ENERGJISË

Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës rreth statistikave të energjisë, në muajin Janar të vitit 2024, prodhimi bruto i energjisë elektrike nga termocentralet ishte 567.16 GWh, ndërsa nga hidrocentralet ishte 23.62 GWh. Përveç kësaj, prodhimi bruto i energjisë elektrike nga era dhe ajo solare ishte 47.42 GWh.


Gjatë të muajit Janar 2024, shifra e energjisë elektrike bruto në dispozicion ishte 842.74 GWh, ndërsa konsumi i energjisë elektrike ishte 596.34 GWh, përfaqësuar nga një rritje prej 6.15% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit total ishte 11.91%.

Importi i energjisë elektrike në muajin Janar të vitit 2024 shënoi një vlerë prej 396.56 GWh, ndërsa eksporti i energjisë elektrike në të njëjtin periudhë ishte 192.02 GWh, duke përfshirë sasi të transmisionit. Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 6.89 mijë ton, që paraqet një zvogëlim prej 13.33% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

PRODHIMI DHE KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE PËR JANAR 2024

Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën e mëposhtme, është e dukshme se në muajin Janar të vitit 2024, termocentralet kanë kontribuar në 88.8% të prodhimit total të energjisë elektrike, ndërsa hidrocentralet kanë kontribuar në 3.70% dhe era dhe energjia diellore në 7.43%.

Ky përqindje e lartë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet tregon se sistemi i energjisë elektrike në vend mbështetet kryesisht në shfrytëzimin e burimeve termike për prodhimin e energjisë. Megjithatë, një kontribut e ka dhënë dhe energjia e ripërtëritshme nga era dhe dielli.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 1, paraqet të dhënat për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike për muajin Janar 2024 në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Prodhimi bruto nga termocentralet është rritur me 1.91% në krahasim me muajin Janar 2023. Kjo tregon një rritje të lehtë në prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, prodhimi bruto nga hidrocentralet ka pësuar një zvogëlim shumë të ndjeshëm prej 67.63% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Prodhimi bruto nga era dhe ajo solare është rritur me 41.59% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo tregon një rritje të ndjeshme në kontributin e energjisë së ripërtërishme në prodhimin total të energjisë elektrike gjatë kësaj periudhe.

Importi dhe eksporti i energjisë elektrike kanë shënuar rritje respektivisht 13.92% dhe 11.86% në Janar 2024 në krahasim me Janar 2023. Kjo reflekton një përdorim më të madh të burimeve të importuara për të përmbushur kërkesën, si dhe një rritje të aktivitetit të tregtisë së energjisë elektrike në këtë periudhë.


Tab.1: Prodhimi dhe konsumi i energjisë elektrike për muajin Dhjetor 2023 krahasuar me muajin Dhjetor 2022

MWH	01-2023	01-2024	I 2024 / I 2023 %
Prodhimi Bruto nga Termocentralet	556 536	567 158	1,91%
Prodhimi Bruto nga Hidrocentralet	72 974	23 621	-67,63%
Prodhimi Bruto nga Era dhe ajo Solare	33 491	47 419	41,59%
Importi	348 091	396 563	13,92%
Eksporti	171 659	192 020	11,86%
Energjia Elektrike bruto në Dispozicion	839 433	842 740	0,39%
Amvisnia	379 591	396 563	4,47%
Komercial	117 971	129 339	9,64%
Industri	44 568	49 816	11,77%
Ndriqimi publik & tjerat	3 879	4 170	7,49%
Konsumatorët 220-110kv	5 390	6 059	12,42%
Mihjet	10 371	10 394	0,22%
Konsumi i energjisë Elektrike	561 771	596 340	6,15%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Bazuar në të dhënat e disponueshme të ASK, sektori i amvisnisë ka qenë konsumatori kryesor i energjisë elektrike gjatë muajit Janar të vitit 2024, duke përfshirë një shpërndarje të konsiderueshme prej 66.5% të konsumit total të energjisë elektrike. Pasuar nga sektori komercial me 21.7% të konsumit total dhe industria me 8.4%.

Fig. 1.1: Struktura e energjisë elektrike e konsumuar sipas sektorëve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sipas tabelës së dhënë për konsumin e benzinës në Kosovë për muajin Janar 2024 në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak, shihet një rritje në importin e benzinës. Importi është rritur nga 4205 ton në Janar 2023 në 5004 ton në Janar 2024, duke paraqitur një rritje prej 19.01%.

	(ton)		
Benzine	01-2023	01-2024	I-2024 / I-2023%
Prodhimi	0	0	0,00%
Import	4205	5004	19,01%
Eksport	0	0	0,00%
Stoku	0	0	0,00%
<u>E gatshme për treg</u>	<u>4205</u>	<u>5004</u>	<u>19,01%</u>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela e mëposhtme paraqet konsumin e dizelit në Kosovë për muajin Janar 2024 në krahasim me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ku shihet se importi i dizelit është rritur me 25.93%.

Në Janar 2023, importi ishte 37946 ton, ndërsa në Janar 2024, ai u rrit në 47786 ton. Kjo rritje reflekton një rritje të kërkesës për dizel në tregun vendor, për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik, transportit, ose nevojave të tjera të konsumatorëve.

Dizel	01-2023	01-2024	I-2024 / I -2023%
Prodhimi	0	0	0,00%
Import	37946	47786	25,93%
Eksport	0	0	0,00%
Stoku	0	0	0,00%
E gatshme për treg	37946	47786	25,93%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org